

**“BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT”**

**TIRANE**

**RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TE REGJISTRUAR**

**Per Auditimin Ligjor të Fondeve të përfituara  
Për Fushatën Zgjedhore 2013**

Tirane 19 Shtator 2013



**RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR**

**KOMISIONINI QËNDROR I ZGJEDHJEVE**

Bulevardi: "Dëshmoret e Kombit"  
Pallati i Kongreseve, Tirane

Të nderuar zotërinj,

Në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Regjistruar, bazuar në Vendimin nr.752, dt.02.08.2013, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe Kontratës të Shërbimit Nr.6647, dt.26.08.2013, kam audituar pasqyrat bashkëlidhur që lidhen me financimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore, që fillon me datë 22.05.2013 me regjistrimin e Partisë "Bashkimi Liberal Demokrat" në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (si subjekt zgjedhor) dhe mbyllet me datë 22.06.2013 me përfundimin e fushatës zgjedhore të 23 Qershor të vitit 2013.

Përgatitja e këtyre pasqyrave është përgjegjësi e drejtuesve të Partisë Bashkimi Liberal Demokrat. Detyra e subjektit zgjedhor është të përgatisë pasqyrat bashkëlidhur mbi bazën e arketimeve dhe pagesave.

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin e kryer. Auditimi u krye në përputhje me Standartet Nderkombetare të Auditimit, referencë të vecantë me SNA 800.

Këto standarte kërkojnë që unë të planifikoj dhe të kryej auditimin për të zotëruar siguri të arsyshme, se këto pasqyra nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare që përfshijnë: Librin e llogarive të subjektit, regjistrin e posacëm të miratuar si model, me vendim nr.266 të KQZ-së, dt.01.06.2009 si dhe pasqyrën e arketim pagesave. Auditimi përfshin gjithashtu, vlersimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlersimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Unë çmoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opiniononin tim të auditimit.

Pasqyrat bashkëlidhidhur te fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partisë "Bashkimi Liberal Demokrat" që fillon me dt.22.05.2013 dhe mbyllet me dt. 22.06.2013 është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën e arketimeve dhe të pagesave, konform ligjit nr.9228 dt.29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

"FILTO Auditing" sh.p.k.

Tirane më 19 Shtator 2013

Tatjana FILTO






## PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT

(Te gjitha shumat jane ne leke)

Balanci kontabel për periudhën zgjedhore mbyllur me 23.06.2013	Shenimi nr.	Periudha 22.05.2013 deri 22.06.2013
<b>AKTIVET</b>		
<b>Aktive Afatshkurtera</b>		
Aktive monetare		320
Aktive tjera financiare afatshkurtra		
<b>Totali i Aktiveve Afatshkurtera (I)</b>		<b>320</b>
Aktive Afatgjata		
Aktive afatgjata materiale		0
Aktivitet afatgjata jomateriale		
<b>Totali i Aktiveve Afatgjata (II)</b>		<b>0</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE (I + II)</b>		<b>320</b>
<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>		
<b>Detyrime Afatshkurtera</b>		
Detyrime ndaj Furnitoreve		0
Detyrime ndaj punonjeseve		0
Detyrime tatimore		0
<b>Totali i Detyrimeve Afatshkurtera (I)</b>		<b>0</b>
Detyrime Afatgjata		
Huamarrje te tjera afatgjata		
<b>Totali i Detyrimeve Afatgjata (II)</b>		<b>0</b>
<b>Totali i Detyrimeve (I + II)</b>		<b>0</b>
<b>PASURIA NETO</b>		
Teprica e burimeve ne fillim te periudhes		0
Rezerva e Drejtimit		
Teprica e burimeve te vitit financiar		320
<b>Totali i Pasurise neto (III)</b>		<b>320</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE PASURISE NETO (I,II,III)</b>		<b>320</b>

Emri Mbiemri Kryetarit  
ARIAN STAROVA  
BLD




**PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT**

(Te gjitha shumat jane ne leke)

Te ardhura Shpenzime për periudhën zgjedhore mbyllur me 23.06.2013	Shenimi nr.	Periudha 22.05.2013 deri 22.06.2013
<b>Burimet (te ardhurat) nga:</b>		
Kuota e antarsisë		0
Fonde publike nga shteti		61,320
Dhurime nga persona fizik dhe persona juridik		10,000
Burime të tjera		0
<b>Totali i te burimeve</b>		<b>71,320</b>
<b>Shpenzime (perdorime)</b>		
<b>Perdorimet per veprimtarine kryesore</b>		0
Marrje salla me qira		0
Reklama televizive		0
Reklama ne radio		0
Shpenzime telefonike		0
Shpenzime për postera, fletëvolante, fletëpalosje		71,000
Shpenzime kancelarie		
Shpenzime për karburant		
Pagesa e firmave konsulente		0
Pagesa për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetsore		0
<b>Nentotali i shpenzimeve</b>		<b>71,000</b>
Teprica e burimeve nga veprimtaria kryesore (1-2)		320
Fitimet (humbjet) nga kursi i kembimi		0
<b>Nentotali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare</b>		<b>0</b>
<b>Teprica e burimeve neto e vitit financiar</b>		<b>320</b>

Emri Mbiemri Kryetarit  
ARIAN STAROVA  
BLD

*(Signature)*





**PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT**  
**BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT**

(Te gjitha shumat jane ne leke)

Pasqyra e rrjedhjes se parase (cash floë) për periudhën zgjedhore e mbyllur me 23.06.2013	Shenimi nr.	Perudha 22.05.2013 deri 22.06.2013
<b>Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit</b>		
Teprica e burimeve para tatimit		320
Rregullime per:		
Amortizimin		0
Rritje/renie ne tepricen e kerkesave to arketueshme nga aktiviteti, si dhe kerkesave to Rritje/renie ne tepricen e detyrimeve, per t'u paguar nga aktiviteti		0
<b>Mjete monetare to perfituara nga aktivitetet</b>		<b>320</b>
Interesi i paguar		-
Tatim mbi fitimin i paguar		-
<b>Mjete monetare neto nga aktivitetet e shfrytezimit</b>		<b>320</b>
<b>Fluksi monetar nga veprimtarite investuese</b>		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale		0
Te ardhura nga shitja e pajisjeve		0
<b>Mjete monetare neto e perdorur ne aktivitetet investuese</b>		<b>0</b>
<b>Fluksi monetar nga veprimtarite financiare</b>		
Hyrje nga huamarrje afatgjata		0
Pagesat e detyrimeve to qirase financiare		0
<b>Mjete monetare neto e perdorur ne aktivitetet financiare</b>		<b>0</b>
<b>Rritja/renia neto e mjeteve monetare</b>		<b>320</b>
<b>Mjetet monetare ne fillim to periudhes kontabel</b>		<b>0</b>
<b>Mjetet monetare ne fund to periudhes kontabel</b>		<b>320</b>

Emri Mbiemri Kryetarit  
**ARIAN STAROVA**  
 BLD

*P. Starova*




# PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT

(Te gjitha shumat jane ne leke)

Pasqyra a ndryshimeve ne pasurine neto periudhen zgjedhore mbyllur me 23.06.2013	Pasuria neto	Periudha 22.05.2013 deri 22.06.2013
<b>Pozicioni i mepareshem</b>		0
Taprica neto per periudhen kontabel		0
Kalimi ne pakasim te pasurise neto		0
<b>Pozicioni me 22.05.2013</b>		0
Taprica e burimeve per periudhen kontabel		320
Kalimi i teprices se burimeve te vitit ne pasurine neto		
<b>Pozicioni me 22.06.2013</b>		320

Emri Mbledhjes Kryetare  
ARIAN STAROVA  
BLD







**TABELA E FONDEVE TË PËRFITUARA NGA PARTIA/KOALICIONI** *Partia Demokratike e Kosovës* **DEPREJ PËRSONAVE FIZIKË OSE JURIDIKË VENDAS, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN 2009**


NR	PËRSHKRIMI I DHURIMIT	VLERA NE LEK	IDENTITETI I PLOTË I DHURUESIT	NIPTI	DATA E DHURIMIT	NR. I LLOGARISË KU U DEPOZITUA DHURATA
1	<i>Asnjë</i>	<i>10.000</i>			<i>17/06/2009</i>	
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						

**SHUMA TOTALE E DHURUAR**  
Shifrë (fjalë) lek

Shënim: Për çdo dhuratë në sende ose shërbime, subjekti zgjedhor do të llogarisë dhe deklarojë kundërvleftën në lekë të sendeve ose shërbimeve duke u bazuar në indeksin mujor të çmimeve, të publikuar nga INSTAT. Për sendet ose shërbimet, vlera e të cilave nuk pasqyrohet në indeksin mujor të çmimeve, subjektet zgjedhore do t'i referojnë çmimit të tregut në momentin e marrjes së dhuratës.

**Partia/Koalicioni/Kandidat i propozuar nga zgjedhësit**

Miratuar me vendimin e KQZ-së nr. 266/ datë 01.06.2009







## I. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

I.1 Baza ligjore kryerjen e këtij misioni është marrë në referim të ligjeve:

- Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".
- Ligji nr.8580, dt.17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar me ligjin Nr.10374, date 10.02.2011.
- Ligji nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar", Standartet Ndërkombetare të auditimit dhe kryesisht (SNA 800).
- Ligji Nr. 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finnciare,.
- Cdo dokument ligjor të marrë prane Partisë "Bashkimi Liberal Demokrat".

## I.2 TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SUBJEKTIN ZGJEDHOR

Subjekti zgjedhor Partia "Bashkimi Liberal Demokrat" e ka fituar zotësinë juridike për të vepruar,ne baze te Vendimit Gjykates Rethit Gjyqesor Tirane Nr. 2122 date 13/04/2005. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit nr. 8580, dt.17.02.2000 "Per Partitë Politike", të Ligjit nr.8788, dt.07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimpruese ", të Ligjit nr.8779, dt.07.05.2001 "Për Regjistrimi e Organizatave Jofitimpruese", nga statuti i saj dhe legjiacioni ne fuqi.

Subjekti zgjedhor "Bashkimi Liberal Demokrat" është një organizatë shqiptare e cila e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Qellimi: Bashkimi Liberal Demokrat eshte parti politike e qendres se djathte e cila mbron idete e zhvillimit te nje sistemi shoqeror me institucione demokratike qe kane ne themel vlerat e shteteve te hapesires Euroatlantike dhe aritjen e mireqenies materiale e shpirtore te Shqiperise e te shqiptareve ne perputhje me idealet kombetare te shqiptareve, drejtesine shoqerore e prirjet e pergjitheshmete zhvillimit te vendeve euroatlantike, duke vepruar gjithnje ne perputhje me Kushtetuten e Republikes se Shqiperise. Ajo ben perpjekje per ti realizuar keto ide nepermjet pjesemarjes ne konkurrence politike dhe zgjedhjet e ndryshme te vendit.

Vemendje e veçante u kushtohet perpjekjeve per mbrojtjen e lirive e te drejtave themelore te njeriut, zhvillimit te ekonomise se tregut te mbeshtetur mbi respektimin e plote te prones private, forcimit te drejtesise shoqerore nepermjet sundimit te ligjit te barabarte per te gjithë dhe mbrojtjes se interesave kombetare e sigurise se te gjithë qytetareve te Republikes se Shqiperise.

Veprimtaria e kesaj partie sipas statutit te saj mbeshtetet ne parimet e demokracise thelbi i se ciles eshte vota e lire dhe e fshehte. Format e punes ne perpjekje te realizimit te qellimeve jane:veprimtaria propogandistike e organizative e anetareve te saj, zbatimi i programit te partise gjate pjesemarjes ne qeverisjen vendore ose qendrore, veprimtaria e grupit parlamentar, bashkepunimi me parti te tjera dhe organizata te ndryshme partnere, bashkepunimi me parti dhe organizata partnere te huaja ose organizata nderkombetare te njohura, takimet publike, konferenca, manifestime zgjedhore,demostrata e protesta, komunikime me median etj.

Qendra e partise është në Bulevardi "Zhan'Dark" Nr.17 Tirane.

Organet drejtuese ne udheheqjen qendrore janë:





## **“FILTO Auditing” sh.p.k.**

- Keshilli Drejtues kombetar
- Mbledhja e Keshilli Drejtues kombetar
- Kryetari i Keshilli Drejtues kombetar
- Kryesia Qendrore
- Mbledhja e Kryesise Qendrore
- Komisioni i Kontrollit te Partise
- Kryetari i Partise
- Bordi keshellimor prane Kryetarit te Partise
- Nenkryetari i Partise
- Sekretari i Pergjithshem
- Zedhenesi i Partise
- Kuvendi Kombetar i Partise

Kryetar i partise është zgjedhur z.Arian Starova i cili është i autorizuar të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për aktivitetin normal të “ Bashkimit Liberal demokrat,„

Mjetet Financiare te partise jane te ardhurat nga Buzheti i Shtetit, kontributet financiare te anetareve, te ardhurat nga shtypi, veprimtari te tjera te organizuara nga partia, ose burime te tjera ne perputhje me ligjin.

### **II. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABEL**

#### **II.1 Mënyra e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare.**

- a) Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar (NKRF), të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin nr.9228 dt. 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finnciare,, dhe Planin Unik Kontabel, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.  
Pasqyrat e paraqitura në raport janë shprehur në monedhen vendase në Leke.
- b) Rregullat për vlerësimin e kërkesave për arkëtim dhe të detyrimeve.  
Kërkesat për arkëtim janë të pasqyruara mbi bazën e vlerës së faturave origjinale të lëshuara nga klientet apo të dokumentave të tjerë kontabël. Detyrimet janë njohur dhe pasqyruar mbi bazen e faturave dhe dokumentave orgjinale kontabël.
- c) Rregullat e vlerësimit të likuiditeteve.  
Gjendjet e likuiditeteve përfshijnë gjendjen e parave në arkë dhe në llogaritë rrjedhese në bankë në leke. U kontrolluan veprimet e kryera në arkë dhe bankë dhe u konstatuan se regjistrimet në librat e llogarive dhe në ditarët përkatës ishin kryer sipas normave kontabël.
- d) Të Ardhurat  
Të ardhurat regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre nga dontorët dhe perdorimi i tyre është sipas planit të buxhetit të financuar nga projekti.



## **“FILTO Auditing” sh p k.**

### 2 ORGANIZIMI I KONTABILITETT

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”. Partia ka ndertuar nje plan të llogarive vetjake në përputhje të plote me Planin Unik Kontabël. Kontrolli i brendshem kryhet nga dega e finances. Kontabiliteti mbahet në menyre manuale.

#### A. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

1.Partia “Bashkimi Liberal Demokrat” ka realizuar të ardhur për fushatën zgjedhore nga buxheti i shtetit ne masen 61,320 leke me date 04/07/2013si dhe 10,000 leke nga individ me date 17/06/2013.

2. “Bashkimi Liberal Demokrat” ka realizuar Shpenzime për fushatën zgjedhore si me poshte:

<u>Nr Rendor</u>	<u>Furnitori</u>	<u>Vlera leke</u>
<u>1</u>	<u>Shtypshkrime “Fatmir Allmuça”</u>	<u>71,000</u>
	<u>Totali</u>	<u>71,000</u>

#### B. Pasqyra e arkëtimeve dhe pagesave

Nga verifikimi i likuiditeteve në arkë dhe bankë rezulton se Partisa “Bashkimi Liberal Demokrat” ka arketuar fonde për fushatë zgjedhore as nga buxheti i shtetit dhe nga donatore te tjere fonde te cilat jane arketuar ne banke.

	<u>Ne fillim të fushatës</u> <u>Lek</u>	<u>Ne fund të fushatës</u> <u>Lek</u>
Depozita në bankë (lek)	0	320
Para në Arkë	0	0
Totali	0	320

Gjate periudhes se auditimit teprica e fondeve ishte konsumuar me komisione bankare te muajit Korrik ne vlore 250 leke. Teprica ne daten e raportit 70 leke.

*“FILTO Auditing” sh p k*

Tirane me 19 Shtator 2013

Tatjana FILTO



Filto Auditing: Adresa: Sheshi Wilson, Kulla e Buzë Kallit, Tirane  
Tel/Fax:04 2203086 cel: 0682047624